

Rini e gjelbër, rritje e gjelbër

Duration: 01.03.2024 - 28.02.2027

Countries:
North Macedonia

EU contribution: € 339 065

Total budget: € 376 739

Implementer:

Macedonian Enterprise Development Foundation, Junior Achievement Macedonia, Association Centre for Education and Entrepreneurship "Moznosti"



Project description:

Projekti “Rinia e Gjelbër, rritje e gjelbër” mbështet integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut, duke nxitur të rinjtë, shkollat, organizatat e shoqërisë civile dhe median të kontribuojnë në mënyrë aktive në zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Ai promovon ndërgjegjësimin mjedisor, praktikat e qëndrueshme dhe inovacionet e qelbra përmes edukimit, angazhimit qytetar dhe aktiviteteve të informimit dhe ndërgjegjësimit publik.

Projekti forcon njohuritë dhe aftësitë praktike në lidhje me ndryshimet klimatike, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë rrethore dhe sipërmarrjen e gjelbër të studentët dhe mësimdhënësit. Përmes trajnimeve, aktiviteteve shkollore dhe hackathon-eve të gjelbra, të rinjtë nxiten të zhvillojnë ide inovative dhe zgjidhje praktike për sfidat lokale mjedisore. Njëkohësisht, projekti ofron mbështetje financiare dhe teknike për organizatat lokale të shoqërisë civile për të zbatuar iniciativa komunitare, të cilat lidhen me prioritetet kryesore të Agjendës së Gjelbër. Ndërgjegjësimi publik forcohet më tej përmes fushatave digjitale, videove, historive të suksesit dhe ngjarjeve publike, të cilat promovojnë stile jetese të qëndrueshme dhe praktika pozitive mjedisore.

Duke lidhur arsimin, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet lokale, projekti kontribuon në një angazhim më të madh të të rinjve, zhvillim më të qëndrueshëm lokal dhe mbështetje më të gjerë publike për tranzicionin e gjelbër në

Expected results:

- Thellim i njohurive mjedisore të të rinjve, aftësive praktike dhe rritje të motivimit për të kontribuar në ndryshimin klimatik dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Përmirësim i kapaciteteve të institucioneve arsimore publike dhe të mësimdhënësve për të promovuar ndërgjegjësimin mjedisor dhe vlerat e gjelbra te nxënësit;
- Shkollat zhvillojnë dhe promovojnë ide dhe zgjidhje inovative të gjelbra përmes trajnimeve, punës në grup dhe aktiviteteve hackathon;
- Mbështetje financiare dhe teknike për organizatat e shoqërisë civile teknike për të zbatuar veprimet konkrete lokale, që synojnë sfidat mjedisore dhe ato të ndryshimeve klimatike;
- Ndërgjegjësim publik për prioritetet e Agjendës së Gjelbër dhe praktikave të qëndrueshme rritet përmes fushatave digjitale, aktiviteteve ndërgjegjësuëse, videoeve dhe ngjarjeve publike.